

AKT-THEMELIMI
I
SHOQERISE TREGTARE “ELBASANI 1913” SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar , sot ~~ne daten~~ ^{24/09/2020} behet themelimi i shoqerise "**ELBASANI 1913**" SH.P.K me seli ne **Elbasan, Lagjja "E Re", rru zk.8524, pasuria nr.5/215** nga ortaku i kesaj Shoqerie **Z.Arben Laze, i datelindjes 13/06/1968**, banues ne Elbasan, i pajisur me karte identiteti me numer personal **G80613070I**.

VENDOSI

Te krijojne nje Shoqeri Tregtare te emertuar "**ELBASANI 1913**" SH.P.K me kushtet e meposhtme:

NENI I

Themeluesi ne cilesine e ortakut krijojne shoqerine tregtare "**ELBASANI 1913**" SH.P.K me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "**ELBASANI 1913**" SH.P.K emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj.

Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar "**ELBASANI 1913**", SH.P.K



NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne:

Elbasan, Lagjja "E Re", zk.8524, pasuria 5/215.

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj.

NENI 6

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :

- **Klub futbollit.**
- **Akademi futbollit.**
- **Menaxhim shit-blerje lojtaresh.**
- **Transport per nevojat e aktivitetit.**

Dhe cdo aktiviteti tjeter te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionit Shqipetar.

NENI 7

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **100.000 leke** (njemilion) leke shqiptare.
Ortaku Z.Arben Laze **zoteron nje kuote me vlere 100.000 leke ose 100 % te kapitalit themeltar.**



NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur. Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga asambleja e ortakeve dhe administratori. Themeluesit me vendim te veçante do te emerohjne dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijojë fondin rezerve. Fitimi neto qe do te rezultojë ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kalojë ortakeve.

NENI 11

Percaktimi i strukture organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te asamblese se ortakeve. Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Xhanini Laze** e banues ne Elbasan, i pajisur me karte identiteti me numer personal **J50328075W**.

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

NENI 12

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE

“ELBASANI 1913” SH.P.K.

Arben Laze

